



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. *1618* Prot.

VauDejes me *10/03/2021*

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Barbullush, Njësia Administrative Bushat, të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtem:

“Dhënie në përdorim të pasurisë Nr.366/2, Zk nr.1100, e llojit Terren Sportiv, me sipërfaqe 10300 m2, në fshatin Barbullush”

Dëgjesa publike do të bëhet me datë 06.04.2021 ora 11.00 në fshatin Barbullush, Njësia Administrative Bushat, duke respektuar masat anti Covid (takim jo më shumë se 10 persona).

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian ÇELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE**

Nr 1542 Prot.

Vau Dejës me 08 / 03 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Mark Bisha

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar z. Kryetar

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Propozimin:

“Për dhënien në përdorim të pasurisë Nr 366/2, Zk nr 1100, e llojit Terren Sportiv, me sipërfaqe prej 10 300 m², ndodhur në fshatin Barbullush”.

Me respekt,

**NE MUNGESË DHE ME URDHER
ZV/KRYETARI
LESTINË NDOJA**


**KRYETARI
MARK BABANI**



Miratoi:

Kristi Bajo: Drejtor i Drejtorisë Juridike Prokurimeve dhe Integrimit

Konceptoi:

Ndoc Baqli: Përgjegjës i Sektorit të Aseteve 

Datë: 08.03.2021

Nr faqeve A4 të projekt-propozimit 1

Nr faqeve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt-propozimin 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE**

Projekt – Propozim

Nr 02. Datë 05.03.2021

Për dhënien në përdorim të pasurisë Nr 366/2, Zk nr 1100, e llojit Terren Sportiv, me sipërfaqe 10 300 m², në fshatin Barbullush.

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar. Në VKM nr. 1423 dt 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, të Qarkut të Shkodrës”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira , enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore ” ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI :

1. Miratimin e dhënies me qira me afat deri në 20 vjet, të pasurisë Nr 366/2, Zk Nr 1100, e llojit Terren Sportiv, fshati Barbullush, me sipërfaqe të përgjithshme prej 10 300 m².
2. Në këtë pasuri mund të ushtrohet veprimtari vetëm në fushën e aktiviteteve Sportive.
3. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, duke zhvilluar sportin, dhe aktivizuar rininë në mënyrë të shëndetshme, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen në investime publike.
4. Vlera dysheme e qirasë mujore, të jetë sipas raportit teknik bashkëlidhur, sipas VKM-së Nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
- 5.

**KRYETARI
MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/ KRYETARI
LESTINË NDOJA**



Konceptoi: Armand Filipi
Miratoi: P/sek. Ndoc Baqli

RAPORT TEKNIK

MBI LLOGARITJEN E VLERËS DYSHEME TË QIRASË MUJORE PËR PASURINË
Nr 366/2, ZK Nr 1100, TË LLOJIT TERREN SPORTIV, NË FSHATIN BARBULLUSH.

Pasuria me nr 366/2, Zk nr 1100, ndodhur në fshatin Barbullush është pronë e Bashkisë Vau Dejës, me certifikatë pronësie Nr 061081 lëshuar me Dt 14.10.2008

Bazuar në pikën 7 të Kreut III, të VKM-së nr 54, Dt 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, vlera dysHEME e qirasë mujore për pasurinë nr 366/2 Zk 1100, e llojit Terren Sportiv, llogaritet si më poshtë vijon:

Sipërfaqja totale e pasurisë është 10 300 m², ndërsa vlera e qirasë mujore, bazuar në pikën 7 të VKM-së së mësipërme është **10/lek për m²**.

Nga llogaritja del: 10 300 m² x 10 lek = **103 000 lek/muaj**.

Ndërsa vlera e qirasë vjetore bëhet: 103.000 x 12 = **1.236.000 lek/vit**.

Hartuesit e Raportit Teknik

Jurist; Armand Filipi



P/sek Aseteve; Ndoc Baqli



KRYETARI

MARK BABANI

NE MUNGESHE DHE ME URDHER

ZV/KRYETARI

LESTINË NDOJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

061081

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 1100
 Numri i Pasurisë 366/2 Volumi 5 Faqe 120
 Adresa e Pasurisë SHKODER - BARBULLUSH
 Lloji i Pasurisë TERREN SPORTIV
 Sipërfaqja Totale 10.300 m² (DHJETE MIJE E TREQINDE) m²
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>KOMUNA</u>	<u>BUSHAT</u>		<u>I</u>	<u>BARBULLUSH</u>
				<u>SHKODER</u>

- është pronar i PASURISE ME NË 366/2
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 921 , L 366/1 , J RRUGË , P 923

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 08.10.2008 Nr. 48

Data e lëshimit të çertifikatës
14.10.2008

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
(ZAVLIN ZADEJA)

HARTA TREGUESE E RREGJISTRIMIT



ZYRA E RREGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUJTSHME

SHKODER

Ing. *[Signature]*

SHKODER

A. IDENTIFIKIMI IPASURISE

ZONA KADASTRALE 1100 NR. PASURISE 366/2 VOL. 5 FQ 120

INDEKSI I HARTES A-34-76 (50-3) SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi Shkoder Q/ë 3423444454

Rr/L. _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V 921

L 366/1

J 224GE

P 923

PRONARI

KOMUNA "BUSHAT"

Dt. 13 / 10 / 2008

Ora 10

S = 10 300 m²

F. SPORTI

